



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.02. 2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit e zhvilluar në datën 28 janar 2019
2. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11055, datë 15.01.2019 “Për kthim për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën””

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Damian Gjijknuri, Fatmir Mediu, Astrit Veliaj dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Bledar Dervishaj- Këshilltar për Çështjet Ligjore i Presidentit të Republikës

Teuta Vodo- Zëvendësministre e Drejtësisë

Katrin Treska- Drejtoreshë e Përgjithshme Rregulltarore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi – përfaqësuese e sektori të Reformave Ligjore dhe Përafrimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Artan LAME- Drejtor i Përgjithshëm i ALUIZNI-t

Valdrin Pjetri- Drejtor i Përgjithshëm i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja - Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Kourumi për të vazhduar me rendin e ditës është i bërë.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së komisionit të zhvilluar në datën 28 janar 2019.

A jeni dakord me procesverbalin?

Miratohet.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr.11055, datë 15.01.2019 “Për kthim për rishqyrtimin në Kuvend të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën””.

Komisioni ynë është komision përgjegjës, relatorë janë kolegët Bashkim Fino dhe Klotilda Bushka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Presidenca, zoti Bledar Dervishaj, këshilltar i Presidentit të Republikës për çështjet ligjore; nga Ministria e Drejtësisë, zonja Teuta Voda, zëvendësministre dhe stafi që shoqëron zëvendësministren; nga ALUIZNI, është zoti Artan Lame, drejtor i Përgjithshëm; nga Drejtoria e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zoti Valdrin Pjetri, drejtor i Përgjithshëm.

Fjalën e ka zoti Bledar Dervishaj për të prezantuar për kolegët e komisionit edhe për opinionin publik arsyet e kthimit të këtij projektligji për rishqyrtim nga ana e Presidentit.

Bledar Dervishaj – Faleminderit!

Kuvendi në seancën plenare të datës 20 dhjetor të vitit 2018 ka miratuar ligjin për kadastrën, i cili është administruar në institucionin e Presidentit në datën 27 dhjetor. Projektligji iu nënshtrua një vlerësimi të thelluar qoftë nga ana kushtetuese, qoftë nga ana formale për mënyrën si ishin ndërtuar dispozitat e këtij ligji. Në përfundim të shqyrtimit Presidenti i Republikës me dekret ka vendosur kthimin për rishqyrtim në Kuvend të këtij ligji, sipas arsyeve që shoqërojnë dekretin.

Presidenti ka konstatuar se disa dispozita të këtij ligji bien në kundërshtim me legjislacionin bazë të së drejtës civile të Republikës së Shqipërisë, cenojnë parimin e sigurisë

juridike, disa dispozita krijojnë, gjithashtu, tension kushtetues, si dhe nuk janë në harmoni me jurisprudencën kushtetuese.

Konkretisht, nenet: 6, pika 1, 13, pika 6, dhe 22 pika 2, të ligjit “Për kadastrën” bien ndesh me legjislacionin bazë të së drejtës civile dhe konkretisht me atë të Kodit Civil. Me ligjin e ri shkrihet institucioni i ALUIZNI-t, i Zyrës së Regjistrimit dhe Agjencia e Inventarizimit të Pasurive të Paluajtshme në një institucion të vetëm që është kadastra. Dy prej këtyre institucioneve janë në varësi të ministrit ose Ministrisë së Drejtësisë. Në ligjin aktual dhe konkretisht në këto dispozita që unë citova institucioni i kadastrës kalon në varësi të Kryeministrit. Në dukje nuk ka ndonjë problem, por po ta krahasojmë me dispozitat e Kodit Civil, nenin 188, rezulton se këto dispozita bien në kundërshtim me këto parashikime, sepse Kodi Civil parashikon që Regjistri i Pasurive të Paluajtshme administrohet nga ministri i Drejtësisë, kjo është një arsye që Presidenti vlerësoi që Kuvendi duhet t’i rishikojë këto dispozita në mënyrë që projektligji të jetë në harmoni me Kodin Civil

Së dyti, ligji “Për kadastrën” cenon parimin e sigurisë juridike edhe sa u takon të drejtave të fituara ose mbrojtjes ligjore, që ofronte ligji i mëparshëm. Konkretisht regjistri i pasurive të paluajtshme duhet të ofrojë së pari, siguri, qartësi dhe garanci te çdo person qytetar që gëzon të drejta pronësie se çdo e dhënë e hedhur, e regjistruar dhe e konfirmuar tashmë nga institucioni respektiv, sot Zyra e Regjistrimit, duhet të ofrojë garanci maksimale se ky informacion që del nga ky institucion, është i garantuar.

Ligji aktual nr.33 i vitit 2013 e garanton më së miri këtë garanci juridike për qytetarët sa i takon informacionit që jepet nga kjo zyrë, ndërsa ligji i ri ul nivelin e garancisë, sepse nuk parashikon procedura të qarta se si një individ do të kërkojë dëmet që mund të pësojë nga një informacion i pagarrantuar.

Ligji Për kadastrën ka një tjetër problematikë në nenin 37, germa “b”. Përmirësimi i informacionit që administrohet në Zyrat e Regjistrimit është një proces i vazhdueshëm dhe i përditshëm në ligjin aktual. Ky nivel përmirësimi shkon tek të dhënat që ka, të cilat administrohen nga zyra e regjistrimit, nesër nga Kadastra.

Në projektligjin e paraqitur në nenin 37 thuhet: “Përmirësimi zbatohet në dy nivele, saktësimi dhe korrigjimi i hartës kadastrale në raport me titujt e pronësisë dhe gjendjes faktive”. Këtu jemi në rregull. Ndërsa te germa “b” thuhet: “Saktësimi i vetë titujve të pronësisë, kur konstatohet parregullsi në përmbajtje ose mospërputhjen me gjendjen faktike”. Pikërisht

“saktësimi i titullit të pronësisë” nuk mund të jetë kurrsesi kompetencë e kadastrës, sepse titujt janë të ndryshëm, aktet administrative janë të natyrave të ndryshme, të cilat i janë nënshtruar edhe një procesi kushtetues në Gjykatën Kushtetuese, në rastet kur është tentuar shfuqizimi i pjesshëm ose anulimi i tyre. Kjo do të thotë që kadastra në administrimin e informacionit ose të drejtave që ajo merr si institucion përthithës mund të korrigjojë titujt e pronësisë, për shembull, të lejeve të legalizimit, por nuk mundet kurrsesi të korrigjojë as të saktësojë përmbajtjen e vendimeve të Komisionit të Kthimit të Pronave. Ne kemi cituar disa vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Së katërti, neni 28, pika 2, në mënyrën si është riformuluar dhe jo integruar me pikat e tjera të këtij neni, paraqet një problematikë të gjatë zbatimi në praktikë dhe mund të ndeshemi që çdokush merr informacion për këdo, ose pasurinë kujtdo, kështu që ne kemi sugjeruar përmirësimin e kësaj dispozite. Pra, nevojitet qartësim.

Në përfundim, ligji “Për kadastrën”, i miratuar, referon në disa nene të tij ligjin për përfundimin e proceseve tranzitore ku thuhet se kadastra ushtron këtë ose atë funksion në zbatim të ligjit për proceset tranzitore, por ky ligj nuk është miratuar ende nga Kuvendi dhe në kushtet kur nuk dihet përmbajtja ose mënyra si do të miratohet, krijon një klimë pasigurie te çdo qytetar. Konkretisht neni 16 pika 7 i ligjit “Për kadastrën” i referohet një neni tjetër të një ligji tjetër që nuk është miratuar ende. Përveç korrigjimit të gabimeve në hartën kadastrale drejtoria vendore ka kompetencë për të korrigjuar pasaktësitë hartografike ose gabimet materiale në dokumentacionin e pronësisë së titujve të dhëna nga organet shtetërore sipas nenit 57 të ligjit për përfundimin e proceseve tranzitore. Jo vetëm që referohet te një ligj që pritet të dalë, por saktësohet edhe neni se ku, ndërkohë që ky ligj nuk është miratuar ende.

Pikërisht mbështetja ose referimi te një ligj i pamiratuar krijon një klimë të pasigurtë për qytetarin, gjë e cila është e elauburuar qartë nga Gjykata Kushtetuese.

Për këto arsye Presidenti i Republikës ka vlerësuar që ky ligj i duhet rikthyer Kuvendit për rishqyrtim me qëllim përmirësimin e dispozitave të tij.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Dervishaj!

Kush nga relatorët e do fjalën?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Unë do të ndalem tek të gjitha argumentet e Presidentit për të shprehur qëndrimin e relatorëve.

Lidhur me argumentin e parë, sipas të cilit nenet 6, 13, 22 të ligjit Për kadastrën bien ndesh me legjislacionin bazë të së drejtës civile dhe ka të bëjë konkretisht me faktin e varësisë institucionale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, qëndrimi ynë është se ky argument i institucionit të Presidentit nuk qëndron për arsye se ligji “Për kadastrën” parashikon krijimin dhe ngritjen e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës si një organ përgjegjës për procedurat e regjistrimit të pasurive si dhe për realizimin e regjistrimit të titujve të pronësisë, të cilët rrjedhin nga një legjislacion kuadër për çështjet e pronësisë dhe konkretisht krijimi i ASHK krijohet si shkrirje e funksioneve të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave ose Ndërtimeve Informale, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

Pra, në thelb kemi të bëjmë me shkrirjen e funksioneve të tri institucioneve në një. Nuk kemi më me një aktivitet, i cili ka të bëjë vetëm me veprimtari regjistrimi të pasurive të paluajtshme, por kemi të bëjmë me një institucion i cili ka funksione më gjerë se kaq. Nëse u referohemi parashikimeve ligjore se si ASHK –ja i ushtron kompetencat e veta, bëhet fjalë për menaxhimin nga një organ drejtues që quhet bordi ose këshilli. Është i njëjti model, i cili qëndron edhe në ligjin e mëparshëm për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, konkretisht ligjit nr.33 të vitit 2012.

Edhe në ligjin aktual menaxhimi i regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bëhej nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive nën menaxhimin e një bordi. Pjesë e atij bordi ishte edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë. Ruhet i njëjti model menaxhimi dhe mbikëqyrjeje. Përveç kësaj, ju rikujtoj se, gjatë shqyrtimit në komision, kjo çështje është diskutuar dhe sa i takon shqetësimin të ngritur për çështjen e varësisë është referuar edhe ligji përkatës për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë, ku pikërisht drejtimi metodik i shërbimeve dhe regjistrimit të pasurive të paluajtshme është hequr si një kompetencë e kësaj ministrie. Është e vërtetë që Kodi Civil e parashikon një kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme kompetencë, e cila është marrë në konsideratë nga ligji “Për kadastrën” në disa drejtime, së pari duke u ruajtur e njëjta mënyrë menaxhimi dhe mbikëqyrjeje me një përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë në Këshillin drejtues siç është edhe aktualisht dhe duke u ruajtur në të njëjtën kohë roli mbikëqyrës për veprimtarinë e regjistrimit, i cili parashikohet qartësisht në nenet e këtij ligji. Në nenin 13, pika 6, flitet konkretisht për monitorimin dhe kontrollin e përhershëm të

progresit të punës dhe cilësisë nga Ministria e Drejtësisë, rregullat e së cilës do të miratohen me një vendim të Këshillit të Ministrave.

Keni cituar në lidhje me këtë çështje një seri vendimesh të Gjykatës Kushtetuese. Gjykojmë se janë interpretuar dhe cituar gabim këto vendime, sepse, nëse ne do t'i referohemi praktikës së Gjykatës Kushtetuese, pikërisht vendimit nr. 17, të vitit 2010, gjykata shprehet qartësisht se administrimi i rregullt dhe ligjor i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është detyrë dhe përgjegjësi funksionale e regjistruarit të këtyre zyrave të cilat nga pikëpamja administrative varen nga kryeregjistruari i zyrës qendrore. Pra, siguria juridike që citohet në argumentet tuaja nuk ka të bëjë me organin e varësisë, por ka të bëjë me faktin e mbikëqyrjes kontrollit, ose garancitë që u jepen shtetasve, të cilëve nuk duhet t'iu cenohen të drejtat e mëparshme, duhet të kenë garanci në të dhënat e tyre në regjistrin publik dhe të gjitha veprimet e zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme t'u përgjigjen interesave të ligjshme të shtetasve. Kjo që unë ju citova është pjesë themelore e ligjit për kadastrën, në nenin 5 ku flitet për parimet e përgjithshme për shërbimin kadastral, ku thuhet: “Shërbimi Publik i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe procedurat lidhura me të udhëhiqen nga këto parime: a. parimi i ligjshmërisë, parimi i sigurisë juridike; b. respektimi i të drejtave të fituara më parë dhe i pritshmërive të ligjshme të subjekteve të së drejtës”.

Nga ana tjetër, do të doja t'ju citoja se kolegjalitetin në menaxhimin e përditshmërisë të zyrave të hipotekës që njihen sot gjerësisht ose të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paligjshme është një koncept që nuk lind për herë të parë nga ky ligj, por është një koncept i sqaruar dhe zbatohet aktualisht nga të gjitha Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme sipas ligjit aktual, i cili e kthen zyrën në një zyrë që administrimin e bën në bazë të organeve drejtuese dhe më i rëndësishmi si vendimmarrës është bordi (në ligjin aktual) dhe në ligjin që do të miratohet është këshilli, në përbërje të të cilit është përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë. Në thelb nuk cenohet as parimi i sigurisë juridike, as bie ndesh me kuadrin tonë ligjor, sa i takon së drejtës civile.

Kështu që ne mendojmë se ky është një argument, i cili nuk qëndron, por duke qenë se ka paqartësi në lidhje me lexueshmërinë dhe të mos jenë këto probleme në zbatimin në praktikë, mendojmë që, përveç parashikimit në pikën 13/6 sa i takon rolit të mbikëqyrësit dhe kontrollit të përhershëm të Ministrisë së Drejtësisë për Agjencinë e Kadastrës Shtetërore të shtojmë edhe një paragraf në nenin 22 pika 3 ku të parashikojmë edhe një rol mbikëqyrës për veprimtarinë e Zyrave

të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Ndryshimet që ne do të propozojmë janë të paraqitura në formë tabelare dhe u janë është shpërndarë anëtarëve të komisionit.

Së dyti, argumenti i zyrës së Presidentit , sipas të cilit parashikimi në mënyrë të detajuar në ligj i normave për shpërblimin e dëmit, që vijnë si pasojë e veprimtarisë së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përbën cenim të parimit të sigurisë juridike dhe standardit kushtetues, gjithashtu, nuk qëndron për një arsye themelore. Në ligjin nr. 11/ 2018, pra në ligjin “Për kadastrën” përveçse në nenin 5 janë parashikuar parimet mbi të cilat e ushtron veprimtarinë e saj Agjencia Shtetërore e Kadastrës, është parashikuar qartësisht dhe krijimi i një fondi të dëmshpërblimit, i cili përbën një garanci që për çdo veprim që zyrat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në kundërshtim me ligjin, mund t’u kenë krijuar dëme subjekteve të së drejtës, që janë përfitues të shërbimeve të këtyre zyrave, të ekzistojë ky fond që, nëse sipas legjislacionit në fuqi do të njihet e drejta e këtij dëmshpërblimi, të lehtësohet ekzekutimi i këtij detyrimi nëpërmjet një fondi që garantohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Argumentet e paraqitura sa i takon kthimit të ligjit për këtë çështje përsëri flasin për siguri juridike dhe unë nuk e kuptoj se ku është çështja me cenimin e parimit të sigurisë juridike për sa kohë që krijohet ajo që është më rëndësishmja, fondi i garancisë. Në atë që lexoj nga argumentimi i dekretit bëhet fjalë për mungesën e normimit të një procedure për përcaktimin e vlerës së dëmit. Kjo çështje nuk mund të parashikohet në ligj, sepse në Republikën e Shqipërisë funksionon dhe është në zbatim ligji nr. 8510 i vitit 1999, për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore. Ky ligj përcakton qartë se cilat janë organet përgjegjëse të administratës që ngarkohen me përgjegjësi në rastet e pretendimeve për dëmshpërblim dhe cilat janë mënyrat e organizimit të shqyrtimit të pretendimeve për këtë çështje.

Ka qenë një çështje shumë e diskutuar edhe në Komisionin e Ligjeve kur shqyrtohej ligji Për kadastrën fakti i procedurës, por duke u nisur nga praktikat një mori praktikashm në faktm që kanë sot institucionetm tek të cilat ka pretendime për shpërblimin e dëmit dhe ku pretendohet që masa e dëmit të përcaktohet me vendim administrativ të organit të administratës shtetërore gjithmonë në kontrollat e kryera nga KLSH-ja janë konstatuar shkelje, sepse, në fakt, edhe nëse do të njihet që një e drejtë është cenuar nga veprimet e administratës shtetërore nga titullari përkatës masa e dëmit është një çështje e cila nuk mund të përcaktohet pa një proces të rregullt ligjor nëpërmjet procedurës gjyqësore, sepse edhe nëse e detajojmë këtu, gjithçka do të jetë pjesë e një konflikti gjyqësor, sepse do të jetë gjykata ajo që do të përcaktojë masën e dëmit. Kemi

diskutuar që përcaktimi i procedurës do të ishte si një lugë bosh që ua japim qytetarëve në ligj, kur prapë do t'u duhet të shkojnë në gjykatë për të përcaktuar vlerën e dëmit. Garancia që jep ligji në kuadër të parimit të sigurisë juridike, ka të bëjë pikërisht me faktin që, nëse një vendim i tillë i formës së prerë do të ekzistojë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të ketë gati një fond të rezervuar në buxhetin e saj për dëmshpërblimet përkatëse në mënyrë që interesat e ligjshme të subjekteve të rivendosen menjëherë nëpërmjet pagesës direkte të dëmshpërblimit.

Edhe për këtë argument shprehemi kundër dhe nuk jemi dakord.

Në lidhje me argumentin e tretë, që ka të bëjë me nenin 37, germa "b", sa i takon faktit të ndërhyrjes jashtë kompetencës, që sipas institucionit të Presidentit, i njihet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në titujt e pronësisë: në referencën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që ka paraqitur në arsyetimin e dekretit institucioni i Presidentit, shohim që janë cituar disa vendime të kësaj gjykate, që në fakt nuk kanë lidhje me situatën që rregullon konkretisht germa "b" e nenit 37, sepse bëhet fjalë për vendimet nr. 27/2010 dhe 43/2011, të cilët, në fakt, me shumë të drejtë sanksionojnë në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese atë që ne jemi dakord, që: "Asnjë organ tjetër administrativ nuk mund të shfuqizojë aktin e një organi tjetër administrativ", dhe bëhet fjalë për vendimet e organeve të kthimit dhe të kompensimit të pronave.

Ne gjykojmë se ky nen është lexuar gabim dhe ka një keqkuptim në qartësimin e të lexuarit të tij dhe, pikërisht për këtë arsye, me qëllim që të mos kemi probleme në praktikë për zbatimin e këtij paragrafi, pra të germës "b", gjykojmë se do të kemi një riformulim të germës "b" të nenit 37, duke e nxjerrë të qartë faktin se veprimet e Zyrës së Kadastrës do të jenë veprime, të cilat mund të përmirësojnë të dhënat në dokumentin kadastral dhe të mos ketë asnjë dyshim sa i takon ndërhyrjes së këtij institucioni në titujt e pronësisë, sepse nuk ka qenë asnjëherë ky qëllimi.

Së katërti, në lidhje me argumentin se cenohen të dhënat personale që administrohen në Regjistrin Publik Dixhital të Pasurive të Paluajtshme, sqarojmë se edhe ky argument nuk qëndron. Dispozita në nenin 28, pika 2, nuk paraqet asnjë rrezik në kuptim të ruajtjes dhe mbrojtjes së të dhënave personale, pasi në ligj nuk është vetëm ky nen, ligji duhet lexuar në tërësi, është detyrimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe institucioneve në varësi të saj, që të garantojnë sigurinë e sistemit të të dhënave, standardet dhe parimet për mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi. Pra, ky paragraf nuk duhet të vlerësohet i shkëputur nga konteksti i të gjithë dispozitës dhe pastaj në harmoni me të gjitha nenet e ligjit, në mënyrë që të dalë e qartë ajo që është parashikuar, që askush nuk merr akses në të dhënat e sistemit përveç pëlqimit të pronarit të

pasurisë së regjistruar dhe këtu përjashtohen rastet e organeve të tjera, që e kanë këtë të drejtë sipas ligjeve të posaçme për ta marrë këtë informacion, si dhe shërbime të ndryshme, si shërbimi noterial për shembull, që kanë të drejtë të hyjnë e të kenë të dhëna për pasuritë e regjistruara në kuadër të transaksioneve që ata kryejnë.

Së pesti, lidhur me argumentin sipas të cilit ky projektligj referon në një ligj tjetër, i cili është ende i pamiruar nga Kuvendi, dua të theksoj se ligji për kadastrën dhe projektligji tjetër që referon ky ligj për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë janë pjesë e paketës së ligjeve për reformën e pronës.

Ligji për kadastrën rregullon organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës së bashku me organizimin e regjistrimit kadastral të shtetit për pronat e paluajtshme, përditësimin e Regjistrimit të Pasurive. Ndryshe nga ligji për

kadastrën, projektligji për proceset kalimtare, ka karakter të përkohshëm deri në arritjen e qëllimeve të tij, ndërsa ligji i kadastrës është ligji që do të rregullojë normimin e veprimtarisë së zyrës së re, e cila krijohet si shkrirje midis ALUIZNI-it, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencisë së Pronave Shtetërore.

Ligjet funksionojnë të ndarë nga njëri-tjetri, aq më tepër ligji për kadastrën është një ligj, i cili do të funksionojë për aq kohë sa do të japë rezultatet e tij dhe nuk është një ligj i përkohshëm, por duke qenë se të dyja ligjet kanë ardhur në Kuvend në të njëjtën kohë, janë shqyrtuar njëkohësisht, në tekstin e të dyja ligjeve ishte parashikuar që do të hynin në fuqi në të njëjtën kohë, për këtë arsye ishin vendosur referencat.

Gjithsesi, duke u nisur nga kërkesat e deputetëve të maxhorancës për të vlerësuar edhe një herë situatat faktike në zonat e tyre elektorale, sa i takon shqetësimeve që kanë qytetarët nëse janë adresuar apo jo të plota në ligjin për proceset kalimtare, ai ligj nuk u miratua në të njëjtën kohë me ligjin për kadastrën dhe është ende në proces rishikimi gjyqësor, sa i takon interesave të qytetarëve në ato zona, ku disa deputetë të maxhorancës kanë ngritur shqetësimet e tyre.

Jemi përpara faktit që dekreti i Presidentit “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit “Për kadastrën”, në njëfarë mënyre i ka humbur edhe kuptimin datës së hyrjes në fuqi të ligjit, datës 1 shkurt, që tashmë ka kaluar. Kështu që kjo do të dojë ndërhyrje në disa dispozita sa i takon jo vetëm hyrjes në fuqi të ligjit, por edhe saktësimin të dispozitave tranzitore të tij. Për sa kohë që edhe ligji tjetër për proceset kalimtare të pronësisë, do të miratohet më vonë, është e nevojshme

që në tekstin e ligjit të kadastrës, në ato nene ku citohet projektligji tjetër, të hiqen këto citime si dhe të rregullohen dispozitat tranzitore në lidhje me hyrjen në fuqi të ligjit për kadastrën.

Në përfundim, duke e parë në kontekstin e përmirësimit për të drejtat e shtetasve, për të shmangur çdo lloj paqartësie të krijuar në leximin e ligjit për kadastrën në lidhje me sigurinë juridike; për të shmangur çdo lloj keqkuptimi në leximin dhe interpretimin e parashikimeve të nenit 28, në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale; për të siguruar sigurinë juridike në ato dispozita që parashikojnë referim te projektligji për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, që do të shtyhet për miratim në një moment të mëvonshëm; për të saktësuar datën e hyrjes në fuqi të ligjit për kadastrën duke qenë se afati aktual i parashikuar është tashmë i pamundur për t'u zbatuar, duke qenë se ka kaluar, duhen bërë disa rregullime në këtë kuptim në dispozitat tranzitore.

Në cilësinë e relatorëve propozojmë miratimin e dekretit të Presidentit dhe disa ndryshime në disa nene të ligjit, duke iu referuar të gjithë analizës që sapo parashitrova, ndryshime të cilat i kemi paraqitur në formë tabele në materialin që iu është shpërndarë anëtarëve të komisionit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Ka pyetje nga kolegët? Zonja Caka ka pyetje.

Silva Caka – Faleminderit!

Lidhur me atë që ndodhi dje, thjesht për kujtesë, pati një debat, le të themi, pse nuk ishte e ftuar Ministria e Drejtësisë, ndërkohë që sot shoh mungesa të përfaqësuesve të EURALIUS-it. Desha të dija nëse i keni konsultuar e thirrur ata në komision.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit shumë për pyetjen!

Në fakt, në komision vihet për punë dhe jo për gallatë. Nëse dikush prej jush e konsideron këtë komision si gallatë, mund të vazhdoni, jeni të lirë.

Silva Caka – A mundem?

Ulsi Manja – Jo, nuk mundeni!

Kush ka pyetje për rendin e ditës?

Silva Caka – Është shumë serioze, sepse, zotëri, nëse do ta kishe konsultuar EURALIUS-in, me siguri sot këtu nuk do të kishim një dekret të Presidentit!

Ulsi Manja – Ju lutem! Ka mundësi të vazhdojmë me pyetjet konkrete lidhur me rendin e ditës, nëse po, atëherë fjala është për ju, zoti Naço.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja ime ka të bëjë me ndryshimet e propozuara nga grupi i punës. A janë konsultuar këto ndryshime me grupet e interesit, pasi shikoj që Presidenti ka propozuar për të ndryshuar rreth 5 nene dhe ju kërkoni ndryshimin e 22 neneve ose rreth 30 % të të gjithë ligjit? Unë do ta quaja dështim të suksesshëm tuajin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zonja Bushka, një përgjigje për zotin Naço, ju lutem.

Klotilda Bushka – Për sqarim, nuk ndryshohen 22 nene, janë 10 apo 11 nene, të cilat në 80 % të tyre kanë vetëm heqjen e referencës në ligjin për proceset kalimtare të pronësisë.

Ulsi Manja – Ka pyetje të tjera?

Nasip Naço – Pyetja ime ishte: a i keni konsultuar këto ndryshime me grupet e interesit? Nuk i jeni përgjigjur kësaj pyetjeje.

Ulsi Manja – Zoti Naço, jemi në fazën e diskutimit të dekretit të Presidentit. Pasi të shprehemi për dekretin e Presidentit, kur të vijmë në fazën e miratimit të ndryshimeve që janë propozuar nga relatorët, merr vlerë edhe pyetja që ju bëtë.

Nasip Naço – Zoti kryetar, pyetja ishte shumë e thjeshtë, nëse jeni konsultuar apo jo lidhur me këto ndryshime me grupet e interesit.

Ulsi Manja – Nëse doni një përgjigje timen nga faza e shqyrtimit dhe miratimit të këtij ligji, përgjigjja është po, ky ligj është konsultuar me grupet e interesit, të cilët kanë qenë prezent në sallë.

Nasip Naço – Për ndryshimet...

Ulsi Manja – Nuk kemi kaluar te ndryshimet ende. Je i avancuar në kohë! Aktualisht jemi te dekreti.

(Diskutime pa mikrofon)

Ka pyetje për projektligjin, se me ju është çudi, kur e rrëzojmë dekretin e Presidentit, thoni se po e rrëzoni, kur e pranojmë atë thoni pse e pranoni! Ndryshimi mes jush dhe nesh është një: interesi ynë është interesi i publikut dhe jo interesi se cili ka të drejtë, Kuvendi apo Presidenti!

Ju lutem, nëse keni pyetje për dekretin, mund të flisni.

Zoti Balykbashi, fjala për ju.

Oerd Bylykbashi – Këto ndryshimet që shoh te materiali që keni përpara, janë paraqitur këtu në komision, apo jo? Ku janë depozituar këto, kur dhe nga kush?

Më jepni ju një përgjigje, si kryetar i komisionit.

Ulsi Manja – Patjetër! Lexo nenin 86/2 të Rregullores dhe aty ke edhe përgjigjen. Ju lutem, ma citoni nenin!

Oerd Bylykbashi – A ka mundësi të përgjigjeni për atë që ju pyeta, sepse unë dua të di se cili i ka depozituar, ku i ka depozituar dhe çfarë janë këto që ka depozituar?

Ulsi Manja – Neni 86/2 i Rregullores thotë: “Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga fillimi i shqyrtimit, paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe sipas rastit edhe propozime për nene të veçanta të ligjit”. Jemi në fazën e shqyrtimit të dekretit, shprehemi për të si fillim, pastaj vijmë te përgjigja e pyetjes.

Ka pyetje të tjera lidhur me dekretin?

Oerd Bylykbashi – E sqarove gabimin tënd, por ne jse!

Ulsi Manja – Ka pyetje tjetër për dekretin?

Silva Caka – Kam një pyetje për relatoren: meqenëse institucioni i Presidencës nuk kishte lexuar asnjë nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Kushtetutën siç duhet, si rregull, ju pse e pranoni dekretin?

Klotilda Bushka – Në radhë të parë, të jeni e kujdesshme në citimet që bëj unë! I thashë qartë se cilat ishin vendimet, të cilat menduam jo se nuk janë lexuar qartë, por nuk u përshtaten situatave që rregullon ligji. Pra, nëse nuk më keni dëgjuar, po jua sqaroj!

Së dyti, jua sqarova të gjitha arsyet pse ne propozuam ndryshimet në ligj. Po të doni jua rendis edhe një herë, por mendoj se isha shteruese në arsyetimin tim. Relacionin e keni përpara të shpërndarë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Nëse nuk ka pyetje, kalojmë në diskutime. Kush e do fjalën.

Ka pyetje të tjera zoti Naço.

Nasip Naço – Zoti kryetar, këtu kemi vetëm një tabelë, dhe nuk e kemi relacionin. Ju lutem që relacioni të na vihet në dispozicion nga sekretaria. Bëjmë 5 minuta pushim dhe pastaj vazhdojmë me diskutimet.

Ulsi Manja – Kur të vijmë në fazën e shqyrtimit të neneve që propozuan relatorët, do të keni edhe relacionin përpara.

Ju lutem, zoti Naço, lexoni rendin e ditës, jemi te shqyrtimi në parim i dekretit, do të pranohet apo jo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Nasip, mos ma bëj pazar komisionin, se unë nuk jam këtu për pazar!

Ka diskutime për dekretin?

Zoti Bylykbashi, fjala për ju.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, besoj të gjithë jemi dëshmitarë këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ke detyrim kushtetues të dëgjosh anëtarët e komisionit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Manja, një nga problemet që ndërkombëtarët po të mbajnë shënim ty është fakti që ti shkel në mënyrë konsistente procedurat e shqyrtimit legjislativ, përfshirë kur iniciativa për ndryshim kushtetues bëhet nga opozita me vendim, ke rrëzuar të drejtën e debatit të anëtarëve propozues për ligjin. Nuk mundesh ti, si kryetar i komisionit, që ke detyrimin kushtetues të menaxhosh këtë mbledhje në mënyrë që të flasin të gjithë, edhe ata që nuk janë anëtarë të komisionit, e të na thuash: “Unë po ju dëgjoj për respekt, përndryshe e fus në votim dhe mbyll!”. E mbylla këtë pikë, se është çështje procedure dhe është çështje parimi. Në qoftë se ti nuk e kupton seriozitetin e kësaj, është problemi yt! U përpoqa ta lexoja atë draftin kushtetues kur ti e votoje pa e lexuar, siç propozonte Pandi.

Tani vazhdojmë diskutimin. Problemi që kemi sot këtu, të nderuar kolegë dhe kushdo që na ndjek, ka të bëjë në themel se si Edi Rama, si Kryeministër, e koncepton gjithë shtetin në funksion të tij, por edhe pushtetin gjithashtu në dorën e tij, por edhe se çdo individ i thjeshtë nuk ka të drejta për më shumë se sa i lejon shteti, e nëse shteti vendos t’ia marrë, ia merr, dhe, mbi të gjitha, të drejtën e pronësisë që është koncept themelor, i cili u rifut që pas vitit 1992, kur u rrëzua komunizmi përfundimisht dhe po e rifusni, pra pa ua marrë që nga viti 2013. Sot kemi një ligj, i cili ka bërë rishpronësimin e pronës së ish-pronarëve, një tallje gjigande për faktin që për 6 vjet nuk u është kthyer prona dhe kompensimet. Edhe ato pak raste që kanë ndodhur, kanë qenë korruptive, prona nuk është kthyer. Kushtetuta e Shqipërisë, ligjet e mëparshme, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Strasburgut e përcaktojnë qartë: “Prona rikthehet te pronari” dhe ju me

ligjin që keni miratuar, dhe kjo është vetëm pasojë e asaj që nisët në vitin 2014, nuk riktheni, por kompensoni në pronën e vet pronarin, praktikisht e rishpronësoni dhe u japim çfarë duam ne. Pra, në 6 vjet jo vetëm keni vënë norma, të cilat rishpronësojnë, dhe ne do t'i shfuqizojmë këto, ta dëgjoni ju, ta dëgjojnë të gjithë, ai ligj do të shfuqizohet dhe të drejtat e pronësisë do të rikthehen tek ish-pronarët, por në 6 vjet jeni tallur me shqiptarët. Në fakt, nëse në fillim dukej si një inkompetencë e Agjencisë së Pronave, më pas si vullnet për ta zvarritur, sot pas 6 vjetësh kuptohet qartë se cili është qëllimi juaj në raport me pronat e pronarëve dhe të ish-pronarëve, ato që ne shohim me shpartallimin dhe shkatërrimin e pronave, kur edhe Gjykata Kushtetuese ju ka prerë duart, megjithatë, ju, pasi e mbyllët me Gjykatën Kushtetuese, vazhdoni sot të shkatërroni çdo të drejtë pronësore në mënyrë brutale.

Ju keni qëllim të pastër, që këto prona të mbahen të bllokuara, të futen në amulli dhe në kaos, në instabilitet juridik, në mënyrë që më pas të vijë investitori strategjik, oligarku i radhës, në të gjithë Shqipërinë, por edhe më shumë në bregdetin e Jugut, dhe në këtë amulli, kur me zor po mbyllim situatat problematike, i rifusim në rrëmujë nëpërmjet një ligji si ky. Pse? Sepse sa më shumë të vijnë vërdallë njerëzit e thjeshtë nëpër agjenci e gjykata, nëpër procese gjyqësore, që do të mbeten të bllokuara për shkak të rrëmujës në sistemin e drejtësisë, atë që keni krijuar sot ju me këtë që e quani reformë në drejtësi, do të jetë shumë më e thjeshtë që të miratohen ligje, të cilat do t'ua grabisin pronën shqiptarëve. Vjen dikush me 30 milionë euro merr gjithë bregdetin e më pas ndërton, kur shkon hallexhiu për të marrë pronën, i thoni: “Na falni, po e kemi kthyer! Do t'ua kompensojmë diku nga Mokra!”.

Keni miratuar ligje në mënyrë konsistente gjatë gjithë këtyre viteve, ndërkohë që mbani pezull të drejtën e pronësisë. Në shkelje të Kushtetutës keni miratuar ligje që nuk bëjnë gjë tjetër veçse grabisin të drejtën kushtetuese të pronës.

Nuk po flas këtu për faktin që në kaq vjet nuk keni transferuar asnjë pronë te pushteti vendor, edhe pse thatë se do të bëjmë reformën territoriale, e cila do të na japë më shumë kompetenca. Ne, që nuk e kishim bërë dot reformën territoriale, u jepnim vazhdimisht prona bashkive, kurse ju asnjë pronë, sepse i duhen Edi Ramës.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, i gjithë pushteti i duhet Kryeministrit për një gjë shumë të thjeshtë, të bëjë ç'të dojë me pronat. Kjo është kënaqësia e tij, mund të jetë edhe perverse, se ai kënaqet me krijimin e konfliktit midis shqiptarëve (ti s'ke pronë, unë ta zgjidh, jam unë gjyqtari). Në fakt, në një vend

kaq të vogël, ku, me sa duket, pronat janë asetet më të mëdha që kemi, ato i duhen Kryeministrit për pushtet, për pasurim, për t'i shkëmbyer për pushtet

Ne të gjithë e dimë se kemi një vit pa Gjykatë Kushtetuese. Këta zotërinjtë përballë janë të gjithë përgjegjës, janë atë që e kanë hartuar, ata që e kanë miratuar pa lexuar, për turp të tyre, dhe ata që sot tundin kokën kot duke thënë se kemi bërë reformë në drejtësi, sepse sot nuk ka asnjë garant të kushtetutës, i cili i thotë “stop” Ulsi Manjës e të tjerëve me radhë, por në veçanti Kryeministrit për ligjet që sjell dhe Ulsi i miraton, se nuk është Gjykata Kushtetuese.

Ju duket si përrallë, dikur ka qenë Gjykata Kushtetuese, e cila rrëzoi ligje që cenonin të drejtën e pronësisë. Ka rrëzuar ligje edhe në kohën tonë GJK-ja, ka vendosur një jurisprudencë, e cila sot referohet dhe ky dekret referon vazhdimisht vendime të Gjykatës Kushtetuese. Po çfarë vlere kanë vendimet e GJK-së, që mbrojnë të drejtat kushtetuese si prona, kur kjo gjykatë nuk ekziston fare, është një përrallë dhe shërben vetëm për footnote, për citim, se vlerë mbrojtëse, me sa duket, nuk ka më.

Kush ka sot mundësi t'i drejtohet GJK-së, individ apo grup interesi, dhe t'i thotë “stop”, se ju po cenoni të drejtën e pronës, hierarkinë e normës, sigurinë juridike, të drejtat e fituara me ligj, parimet e shtetit të së drejtës? Kujt duhet t'i drejtohet, nëse pas ca kohësh do të merren në shqyrtim dhe të merret edhe një vendim çfarëdo?

Për fat, në këtë moment, Presidenti i Republikës po detyrohet të marrë një rol që në mënyrë tipike është i GJK-së, nuk e pengon Kushtetuta, madje e incentivon, por ky boshllëk po shkakton një lëvizje tektonike në funksionimin e shtetit shqiptar. Po detyrohet Presidenti i Republikës t'i thotë parlamentit “ndal” se ka probleme me Kushtetutën në mënyrë të vazhdueshme, ligji për teatrin e më radhë. Ky është i fundit. Sigurisht, kaq ka në dorë, citon jurisprudencën kushtetuese dhe ju thotë “thirrini mendjes, shiheni edhe një herë ligjin” dhe ky është një nga dekretet më të mira që kam parë deri më sot për sa i përket ngërçit.

Duhet të shqetësohemi për faktin pse po na duhet kaq shpesh të futet në lojë Presidenti për t'i thënë “stop” parlamentit. Parlamenti sot është vetëm noter, vë vulën sa herë vjen një projektligj ose nga Kryeministri apo grup deputetësh të maxhorancës, kalon pa problem, madje dalin relatorët dhe e polverizojnë Presidentin dhe e bëjnë copë, e atomizojnë fare dekretin. Pra, duhet të shqetësohemi thellësisht për faktin se sot për mungesë të garancive dhe garantëve të Kushtetutës kjo maxhorancë është bërë kaq agresive, ndër të tjera po gllabëron me çapa të mëdha

pronat e shqiptarëve, duke filluar nga Kryeministri e duke shkuar të eksponentët e maxhorancës, po grabisin pronat e shqiptarëve.

Ky ligj sot është jo vetëm vazhdë, por një nga instrumentet më të rrezikshëm. Unë dëgjoja këtu komentet e përfaqësuesve të maxhorancës në lidhje me këtë ligj dhe vërtet është shqetësues fakti, lehtësia poetike me të cilën rrëzojnë shqetësimet që ngre Presidenti i Republikës.

Jo, kjo nuk qëndron, pastaj 17 paragrafë për të arsytuar, të për bërë rrëmujë dhe unë sfidoj këdo për të kuptuar çfarë u tha, cili ishte problemi dhe pse e rrëzuar (atë e di partia).

Kryeministri mund të bëjë çdo lloj sharlatanizmi me ligjet që sjell, por ne kemi detyrë o t'ia kthejmë mbrapsht, o t'ia ndryshojmë, kur kemi mundësi. Të sillet një ligj që bie ndesh me hierarkinë e normave, kur Kodi Civil përcakton qartë që regjistri i pasurive është në vartësinë e Ministrisë së Drejtësisë, e thotë qartë këtë dhe jo po ne po e bashkojmë, po e llokoçisim pak me gjysmë institucioni andej, me $\frac{3}{4}$ e një institucioni tjetër dhe në fund fare themi që marrim edhe këtë element. Ore, mund t'ia marrim edhe Ministrisë së Drejtësisë, nuk është ky problemi, megjithëse në këndvështrimin tim ndarja e kompetencave edhe brenda qeverisë është pjesë e sistemit të kontrollit dhe balancat, nuk mund të jetë çdo gjë e Kryeministrit, por mbi të gjitha kemi një ligj me $\frac{3}{5}$ që përcakton se kjo është e Ministrisë së Drejtësisë, nuk mund të jetë e Kryeministrit.

Çfarë po bëni? Po talleni me shqiptarët?

Sigurisht, një përfaqësuese juaja e shquar pati guximin dhe kurajën t'i shkonte e t'i thoshte GJK-së se Kushtetuta ndryshohet edhe me akt normativ. Çuditi dynjanë! Ju e promovuat, po kjo është jo thjesht shprehje lapidare e injorancës, por është shprehje lapidare e këndvështrimit që ka Kryeministri, që “edhe me VKM po të dua e ndryshoj Kushtetutën”. Ju thoni se nuk ka problem, pavarësisht se e thotë Kodi Civil, ne ia marrim sepse e ngatërruam me këtë tjetrën, e përziem e llokoçitëm. Budallallëku më pas ulërit në momentin kur ligji referonte ligje që nuk ekzistojnë.

Diku në atë programin tuaj keni një copë letër që ka edhe një titull ligji, që ju i referoheni. Po cila është garancia e shqiptarëve se ju do ta miratoni këtë ligj? Po sikur të ndërroni mendje? Po sikur t'ju dalë EURALIUS-i, se s'kemi GJK, por kemi EURALIUS-in, që vlen më shumë se Presidenti i Republikës, dhe mund të thotë se nuk jam dakord me Presidentin e Republikës? Pyeteni njëherë! Po sikur t'ju dalë kundër, çfarë do të bëni?

Do të mbetet bosh? Mënyra se si e keni shkruar ligjin dhe pakujdesia juaj, më pas do të prodhojë një pasiguri të frikshme juridike për të gjithë shqiptarët, jo për ju, se ju i zgjidhni

problemet, se e keni vartës të Kryeministrit këtë institucion, ju paskeni hyrë 20 herë pa e pasur mendjen, sepse e miratoni ligjin pa e lexuar, por e lexoi Presidenti, për fat.

Kjo tregon jo thjesht cilësinë skandaloze të ligjit dhe të procesit legjislativ, të noterit që vulos çka i vjen nga Kryeministri, por tregon konceptin që keni për të drejtat themelore kushtetuese të shqiptarëve, që mund t'i merrni dhe t'i bëni rreckë sa herë të doni.

Këto janë probleme të karakterit që askush s'i pranon, duken formale, por janë themelore për sigurinë juridike, për stabilitetin e normave juridike, për shtetin e së drejtës në themel. Shkon edhe më larg. Parimi i mbrojtjes së të dhënave personale është parim kushtetues, ndaj ju nuk mund a merrni kaq lehtë. Nuk mund t'ia lini autoritetit tuaj të mbrojtjes së të dhënave, nëse ata ndërhyjnë, dhe këtij institucionit tuaj, nëse bën rregull. Po edhe kjo nuk është më e rënda (sikur të ishim deri këtu, shumë keq, por prapë mirë). Keni marrë përsipër në ligjin tuaj, që në konceptin tuaj, që detalizohet edhe te ky ligj, se si mund të grabisni pronën, si i jepni të drejtë një institucioni të hyjë te titulli i pronësisë, ta grisi titullin e pronësisë së qytetarit që e ka marrë që në 1997-n dhe t'i thotë: “Stop! Po ta gris pak këtë vendimin dhe po të bëj siç di unë”. Pra, keni krijuar një ALUIZNI-in tjetër. Keni vendosur një gjykatë brenda këtij institucioni. Është ky institucion që e di ai kur është titulli i saktë.

Në atë babëzinë tuaj se si e keni këtë histori, shkoni edhe më larg, një gjë që është tmerrësisht keq, ku lejohet saktësimi i vetë titujve të pronësisë, s'është e ka sot ligji, jo projektligji, por ligji 111/2018.

Saktësimi i vetë titujve të pronësisë, kur konstatohen parregullsi në përmbajtjen e tyre ose mospërputhje me gjendjen faktike, shkoni më larg në kohë, e bëni gropë deri në fund.

Nuk mund të ketë titull, të cilin e ka në dorë qytetari që t'ju rrijë ju përballë, sepse ju thoni “përputhja e të dhënave të titujve të pronësisë me gjendjen faktike të pasurisë”, pra vë edhe metrin ALUZNI i ri dhe e këput titullin e pronësisë, të rroftë letra që ke në shtëpi (kështu më doli mua nga sateliti, po ta marr këtë pronën, gjysmën e oborrit nuk e ke ti, se më duhet mua). Pra, jeni gati të rishpronësoni, se kur preket një titull pronësie, praktikisht po rishpronëson. Një titull pronësie gjysmak nuk është më titull pronësie. Kaq larg po shkoni ju. Harroni fare se GJK-ja ka ndërhyrë dy herë, të paktën, kur edhe pse me qëllimin tonë të mirë, ne donim të shfuqizonim tituj që eventualisht ishin korruptiv, haptazi korruptiv. Jo, tha GJK-ja, ju nuk do ta bëni këtë.

Po i jepni këtij institucioni një lloj mostre që bashkon pjesë që në fakt janë të ndryshme nga njëra-tjetra, i jepni mundësinë të hyjë dhe të fusë në zgafellat e veta, të fusi në proces rishikimin

e titullit të pronësisë, që cenon të drejtën e individit, atij hallelxiut që kryeministri nuk e pyet kurrë.

Gjë më të rrezikshme se kaq për të drejtën e pronësisë nuk ka. Sigurisht, ky është koncepti i shtetit, tipik i majtë, ku individët janë në funksion të shtetit, jo të individëve të cilët kanë shtetin, që punon për ta.

GJK-ja përcakton në mënyrë thelbësore rëndësinë që ka regjistri i pasurive të paluajtshme për stabilitetin juridik dhe në qoftë se ju nuk e respektoni këtë, sigurisht që do të vijë një ditë që GJK-ja do t'ua kthejë mbrapsht, ajo tjetra.

Një gjë duhet ta keni parasysh, po bëni një gabim thelbësor duke bashkuar dy institucione që nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin, janë dy pjesë të ndryshme të cilët duhet të kontrollojnë njëri-tjetrin.

Dikush që i jep një titull pronësie nga ajo që është pronë e shteti ose ajo që ka të drejtë shteti ta japë, qoftë edhe ALUIZNI, duke ia marrë dikujt dhe duke ia dhënë dikujt tjetër, se kështu e keni ndarë me ligj, dhe dikush tjetër...

(Diskutime pa mikrofon)

Ka një element thelbësor. Regjistri i pasurive të paluajtshme është një tabelë afishimi, nuk mund të jetë një organ i cili vendos për pronat, sado ju e fshihni nën institucione të tjera që japin prona, i vini një emër tjetër, AKSH a diçka e tillë. Në themel të tij është një element i përhershëm, që është regjistri i pasurive. Pa regjistrim në këtë regjistër Kodi Civil nuk lejon transaksionet e pasurive të paluajtshme. Ka një rëndësi thelbësore, thotë GJK-ja, por vendimi unifikues i vitit 2010 (numrin nuk ia kujtoj), i Gjykatës së Lartë e bën shumë të qartë, nuk përmendet këtu, por po ta kërkonim e gjeni.

Titulli i pronësisë perfeksionohet në momentin kur lëshohet titulli, askush tjetër nuk ndërhyt më. Nëse ka dalë nga një kontratë, nga një akt trashëgimie apo një akt i administratës, që transferon pronësinë, askush tjetër nuk ndërhyt.

Regjistri juaj nuk është moment perfeksionimi, thotë Gjykata e Lartë, regjistri jo, Regjistri i Pasurive të Paluajtshme, është vetëm një tabelë afishimi i të drejtës së pronësisë së individit, që të tjerët të marrin vesh se çka ndodhur, kush është pronari dhe mos të cenohen pronat. Ju nuk mund ta ktheni apo ta rrëzoni këtë koncept themelor që është jo vetëm jurisprudenca, por edhe doktrina.

Ju e bëni këtë. Mendoni se po e bëni për një arsye shumë të thjeshtë, sepse doni t'i jepni mundësinë atij drejtorit në vartësi të Kryeministrit që të hyjë nesër me thikë në dorë dhe të presë pronën, kaq na duhet ne, këtë pjesën tjetër merreni ju.

Ndryshe nga dekreti i djeshëm, i cili ndërhynte në disa nene specifike, ky dekret edhe në ato raste kur referon në nene, në fakt problemin e ka me sistemin, e ka me parimet kushtetuese, e ka te rreziku që i vjen të drejtës së pronës në koncept dhe të drejtave individuale të pronarit, nëpërkëmbja, shkelja, dhunimi i këtyre të drejtave nga shteti, se nuk mjaftoi 50-vjeçari, se nuk mjaftoi amullia e një tranzicionit, por përsëri të fillojmë edhe një herë nga fillimi. Kushedi deri kur do ta marrin vesh shqiptarët pronën e vet.

Në qoftë se ky ligj nuk rikonceptohet, pronat e shqiptarëve cenohen në mënyrë thelbësore. Presidenti i Republikës ka vënë në pah rrezikun e cenimit të parimeve të shtetit të së drejtës, por ato që kanë të bëjnë me individët, jo me Kryeministrin, se Kryeministri nuk i deklaroi këto pasuri.

Edhe diçka në fund fare në lidhje me procesin. Unë ju dëgjova që thotë se propozojmë pranimin e dekretit, pasi rrëzuar të gjitha argumentet dhe me sa duhet dekreti duhet të bjerë vetëm për faktin se “ups, se harruam, e shtuam këtë ligjin edhe pse nuk është miratuar, edhe na ikur data 1 shkurt e hyrjes në fuqi, pra nuk ka të drejtë Presidenti, por të drejtën e kemi ne”.

Për të gjitha këto që thotë, Presidenti i Republikës ka të drejtë dhe ky ligj duhet të rrëzohet nga ky parlament, duke pranuar dekretin e tij. Pra, ligji 111/2018 duhet rrëzuar nga parlamenti shqiptar, duke pranuar dekretin e Presidentit.

Pyetja ime e mëparshme nuk ishte e rastësishme. Ky parlament çeli në mënyrë të rrezikshme procesin ose procedurën e ndryshimit të ligjeve të vdekura. Nëse dekreti i Presidentit pranohet nga parlamenti, do të thotë që ligji është rrëzuar. Kjo është praktika e çdo parlamenti normal.

Presidenti nuk mund ta dijë se kush është iniciatori, mundet edhe ta dijë, por nuk ka rëndësi për të. Me të vërtetë keni një nen në Rregullore, por s' do të thotë që ai përputhet me normën kushtetuese.

Ky ligj sot është një ligj që ka një numër, është miratuar në seancë. Parlamenti sot ftohet vetëm për diçka nga Presidenti i Republikës, me problemet që ngre, akoma jeni në gjendje ta miratoni apo do ta rrëzoni.

Sigurisht, siç thotë neni 68, pika 4 e Rregullores, nëse rrëzohet ligji për shkak se pranohet dekreti, Kryetari i Kuvendit e merr ligjin dhe ia kthen iniciatorit, KM-së, ja ku i ke problemet, i

thotë, këto janë edhe debatet e bëra, merre edhe rishikoje ligjin, pastaj na e sill dhe ne e rimiratojmë.

Ju mund ta rimiratoni përsëri keq, pavarësisht atyre që u thanë, por rëndësi ka që, të paktën, ju nuk mund ta riktheni, ju nuk mund të hapni proces. Procesi legjislativ është mbyllur. Këtu nuk mund të ketë më amendamente. Ky Komision Ligjesh e ka mbyllur procesin e amendamenteve. Mos lexoni nene të cilët nuk kanë përputhje ligjore. Ky nuk është projektligj. Amendamentet ju i bëni vetëm për projektligjet. Ky është një ligj me një numër, me një datë, është i mbyllur, është kthyer mbrapsht nga Presidenti i Republikës e, për rrjedhojë, nëse pranojmë dekretin, ky ligj bie dhe rihapet një proces i ri. Nëse kjo ju kërkon pak më shumë punë, lodhuni dhe bëjeni, bëjeni në të njëjtën kohë me atë ligjin që nuk kemi miratuar ende.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Sa për sqarim, Rregullorja përputhet plotësisht me normën kushtetuese dhe nuk mendoj se një rregullore e miratuar me konsensus

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, një rregullore e miratuar me konsensus, që nuk e kam miratuar unë, as ju me votat tuaja, por është miratuar kohë më parë nuk u përputhka me normën kushtetuese!

Gjithsesi edhe neni 68/4 i Rregullores që i referoheni, i referoheni gabim, se flet për projektligjin, kur Kryetari i Kuvendit u kthen projektligjin nismëtarëve. Këtu nuk po flasim për projektligj, por për dekretin e Presidentit.

E dyta, për hir të faktit që jam kryetar i Komisionit edhe unë jam njohur me praktikën e mëparshme të punës dhe të drejtimit të këtij komisioni edhe nga paraardhësit e mi, por edhe kur ky komision është drejtuar nga opozita e sotme, dje në maxhoracë. Kur ky komision është drejtuar nga ju, aty është arkivi i parlamentit, ka dokumente parlamentare, opozita e kohës, apo ne në atë kohë në opozitë dhe sot jemi në shumicë, për ju kemi qenë thjesht numra, ndërsa sot për aq kohë sa keni ardhur në këtë komision, merrni statistikën e punës së vitit 2018 për Komisionin e Ligjeve dhe do të shikoni se nga 166 orë diskutime dhe debate në këtë komision, kush e ka pasur shumicën e kohës në dispozicion ju apo ne? E solla këtë gjë në vëmendje për të thënë se në këtë komision jo vetëm që nuk vuajmë për hapësirat e lirisë së mendimit, diskutimit apo debatit, por ndoshta koha e tepër në dispozicion është shpërdormi i debatit dhe i diskutimit, por ky nuk është shqetësimi im. Unë jam i detyruar të zbatoj Rregulloren e Kuvendit me konsensus nga parlamenti

i Shqipërisë. E vetmja gjë që kam në dorë është të drejtoj komisionin, të zbatoj Rregulloren e Kuvendit, por për të gjithë ata që kanë vendosur të ankohen apo të qahen, unë kam në dorë vetëm t'u jap shaminë, nuk kam gjë tjetër në dorë!

Fjalën për diskutim e ka kërkuar zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Diskutimi që po bëjmë sot është për një dekret dhe sipas Kushtetutës, Presidenti ka të drejtë ose ta miratojë një ligj ose ta kthejë atë me argumentet përkatëse. Deri këtu jemi në rregull. Ka një material shumë shterues nga ana e relatores me argumente siç i mendojmë ne. Diskutimi që bënë sot përfaqësuesit e opozitës apo ky që dëgjova më tepër kanë të bëjnë me shqetësimin në thelb të ligjit. Duhet të dallojmë dy gjëra: diskutimin e projektligjit kur bëhet në themel dhe diskutimin e tij kur Presidenti me dekret ta kthen për një, dy, tre, katër argumente dhe të thotë: “Shikoni këto nene!”. Për nene të caktuar për të cilat Presidenti e ka kthyer, kemi bërë një material shumë shterues, shumë të mirë, ku e pranojmë dekretin e Presidentit për shkak të atyre argumenteve që u thanë, nuk dua t'i përmend edhe për shkak të ligjit që ishte paralelisht për të kaluar me ligjin “Për kadastrën” dhe për arsyet që u thanë këtu, nuk e kaluam, se duhet të bëjmë ndryshimet përkatëse. Ajo që më vret veshin, a e dini cila është? Zotërinj opozitarë, Presidenti është i të gjithëve. Nuk është juaji. Në momentin kur e merrni sikur e keni tuajin e vrisni edhe atë. Ndonjëherë bën ndonjë veprim gabim dhe ai ndonjëherë bën ndonjë gjë politike dhe e vrisni edhe ju kur bëni këtë diskutim kaq politik në parlament. Presidentit me Kushtetutë i takon të shprehet me dekrete për ligje të caktuara. Kur ne pranojmë një dekret, ju hidheni përpjetë dhe qaheni. Kur ne nuk e pranojmë një dekret, ju përsëri hidheni përpjetë dhe qaheni. Unë nuk arrij të kuptoj një gjë: ju po e përdorni politikisht një President, i cili është i të gjithë shqiptarëve dhe fatmirësisht apo fatkeqësisht është zgjedhur nga kjo maxhorancë me pjesën e asaj opozite që sot është në opozitë dhe dje ishte në maxhorancë. Mendoj se ju nuk bëni mirë, pasi po e përdorni Presidentin si njeriun që është juaji, por nuk është juaji. Jo, Presidenti është i të gjithë shqiptarëve!

Ne diskutojmë për projektligje të caktuara. U fol këtu për grabitjet, për sorollatjet, për reformat territoriale, për ligjin e shpronësimit dhe të gjitha këto me radhë. Pse? Ne duam të organizojmë një institucion, ta bashkojmë. Ndoshta ju deputetët e opozitës nuk e keni vënë re se çfarë ndodh në terren. Unë vij nga terreni nga një zonë që ka probleme. Deri dje duke pasur 3-4 institucione, ALUIZNI-n, një për dhënien e pronësisë, një për hartografinë, e të tjera me radhë, kështu në këtë mënyrë sorollatet qytetari, kur janë 3 apo 5 institucione, sorollatja është më e

madhe. Kjo ka ardhur si rezultat e asaj që kemi dëgjuar në bazë, të cilët na kanë thënë: “ Për të marrë një copë letër që na takon, ta legalizojmë (një proces që është i suksesshëm në qeverisjen tonë, jo në tuajën) do një mandat të plotë”. Pra, do një certifikatë pronësie, certifikatën e pronësisë nuk mund ta japë ALUIZNI përpara hipotekës. Çfarë ndodhte në terren? Qytetari sorollatej për këtë gjë. Mund ta merrte legalizimin dhe i duhej kohë për të marrë certifikatën përkatëse. Çfarë po bëjmë ne? Ne po bëjmë një organizimin duke i bashkuar që qytetari të shkojë në një portë, në një sportel për të marrë një të drejtë të tijën. Tani hidheni përpjetë këtu dhe na thoni: “ Deri dje ky institucion ka qenë te ministria e Drejtësisë, sot pse e kalojmë te Kryeministri?”. Çfarë lidhje ka kjo? A është ky Kryeministër apo kushdo kryeministër tjetër nga Kushtetuta që ka në varësi të gjitha ministritë përkatëse? Ku është problemi këtu nëse një institucion varet nga një ministri? Me riorganizimin e ri që bëjmë ne mund të varet nga Kryeministri. Këtu nuk shikoj asnjë lloj problemi. Pse duhet ta them një gjë të tillë? Prandaj mendoj se ju shqetësoheni kot edhe për Presidentin, kur punon, kthen një projektligj dhe kur nuk punon, nuk kthen projektligj. Unë dua të them se diskutimet që bëni në funksion të retorikës politike, për datën e radhës të protestës së radhës, mirë bëni, është e drejta juaj, edhe politikë do të bëjmë, por ne këtu në komision në fund të fundit, jemi për të dhënë zgjidhje, për t’i dhënë përgjigje një dekreti që Presidenti e ka kthyer.

Në respekt të Kushtetutës ne jemi duke respektuar këtë gjë, duke dhënë argumentet tona përkatëse dhe duke pranuar disa nga vërejtjet përkatëse. Këtu u tha: “Çfarë keni bërë? Turp t’ju vijë!”. Çfarë të keqe ka? Prandaj janë këto filtra. Ku është problemi? Nëse ne kemi bërë gabim një projektligj dhe e kemi kaluar dhe pa praninë tuaj, nuk keni qenë, se po të ishit këtu, ndoshta do të kishim bërë ndryshime edhe më esenciale. Pse është filtri i dekretit të Presidentit? Për këtë punë është në fund të fundit. Të thotë: “ Stop, për një, dy, tre, duhet ta kontrollosh, ta korrigjosh dhe të tjera me radhë”. Rikthehet këtu dhe ne e rishikojmë përsëri. Do të marrim iniciativën se kush e ka kthyer më tepër? Pse në kohën kur ishit ju, nuk janë kthyer projektligjet nga Presidenti dhe nga Presidenti juaj?! Për fat të keq nuk kemi pasur ndonjëherë president të PS-së që t’ju përfaqësojë juve. Mund të jenë propozuar, por nuk kanë qenë ndonjëherë tanët. Nga presidentët tuaj janë kthyer plot ligje, po në kohën tuaj. Ne përsëri e kemi respektuar dekretin e kthimit të Presidentit duke e diskutuar në komision. Unë mendoj se pa dashur të bëjmë retorikë politike, nuk jam jurist do të më pëlqente diskutimi profesional juridik, nëse mund të ketë, por nëse ne e pranojmë dhe themi: ky dekret i Presidentit për shkak të atyre argumenteve që dha në mënyrë shume shteruese relatorja, e pranojmë dhe për shkak të nenit 86 të Rregullores ku thuhet se për

atë që pranojmë, mund të bëjmë ndryshime të disa neneve të caktuara, kjo nuk ka asgjë të keqe, por përkundrazi ka një rregullim të mëtejshëm të ligjit dhe në funksion të atyre diskutimeve që bëri përfaqësuesi i Presidentit. Mund të mos pranohen të gjitha çështjet përkatëse, por këtu është një çështje që do të rishikohet edhe një herë nga Presidenti kur ne të bëjmë ndryshimet përkatëse të këtij formulari që kemi këtu, të neneve të caktuara. Do të jetë përsëri Presidenti, i cili do ta rishikojë ligjin e miratuar nga ana jonë për ta kthyer apo për ta miratuar. E rëndësishme është që ligji t'u shërbejë qytetarëve, e rëndësishme është që ne të krijojmë një agjenci në funksion të këtyre qytetarëve, t'u vijmë në ndihmë atyre, por pa këtë retorikën politike që përdori kolegu im pak më parë, se do ta presim oborrin gjysmë për vete dhe gjysmën për Edi Ramën. E bëtë Edi Ramën super të pasur, se po merr pronat e gjithë të tjerëve, por harrojnë sesi i kanë marrë pronat e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk dua të bëj replika personale, kam dokumentet, dosjet këtu, që kur duan ndonjë gjë personale, ta dijë publiku, këta të opozitës shkojnë nga mbrapa zyrave dhe thonë: “Më duhet kjo, ta marr këtë?”. Këtu u qajnë hallet qytetarëve të tjerë, problemet e tyre i zgjidhin më kollaj, më ndryshe.

Ne bëjmë një ligj për të gjithë qytetarët që të jemi korrektë me ta dhe të mos sorollaten nëpër sportelet përkatëse. Ky është ndryshimi që bëjmë për ta. Prandaj dua të ndërpres këtu diskutimin, të mos bëj edhe unë retorikë politike, të mos bie edhe unë pre e diskutimeve të mëparshme, por të miratojmë pranimin e dekretit, zoti kryetar dhe këtë tabelë që kemi shpërndarë për të gjithë anëtarët e komisionit sipas neneve përkatëse ndryshimet që ne pranojmë të bëjmë dhe ta dërgojmë në seancë për ta miratuar.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Naço nga opozita.

Nasip Naço - Faleminderit!

Në radhë të parë dua të falënderoj përfaqësuesin e Presidentit të Republikës, i cili në mënyrë shteruese na bëri një paraqitje të plotë. Nuk dua të harroj edhe dy relatorët e këtij komisioni, të cilët në mënyrë inovative, e them kështu, sepse kanë propozuar rreth 22 ose 30% nene për të ndryshuar, nga 5 që kërkoi Presidenti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, nuk më takon të them për përfaqësuesit e tjerë të cilët janë të nderuar, por kanë dalë zbuluar nga këto propozime inovative që kanë bërë dy relatorët. Jemi ende në kohën e

duhur, për të diskutuar rreth këtij projektligji. Jam dakord me Rregulloren dhe nenin 86, paragrafi i dytë ku thuhet: “ Komisioni sipas rastit mund të bëjë propozime për nene të veçanta”, por kur janë propozuar 22 nene për të ndryshuar nuk janë të veçanta, pra ka ndryshuar thelbi i të gjithë projektligjit. Besoj se jemi ende në kohë për të pasur një konsensus të gjerë në lidhje me këtë projektligj.

Jemi ende në kohë që me konsensus të bëjmë ndryshimet përkatëse dhe të japim konsensusin, sepse çështja e pronave është një çështje shumë e rëndësishëm për të gjithë qytetarët, qofshin në maxhorancë, qofshin edhe në opozitë. Nga eksperiencat e kaluara çështja e pronave ka pasur probleme në Shqipëri. Jam plotësisht dakord që të ndryshohen ligjet “ Për kadastrën”, “ Për hipotekën”.

Unë do të them vetëm disa fakte zoti kryetar, gjatë vitit 2005 si drejtues i prokurorisë në Durrës kemi hetuar dhe kemi dërguar për gjykim kryetarin, anëtarët e Komisionit për Kthimin e Pronave të cilët në mënyrë abuzive kishin dhënë 220 vendime, me dhjetëra hektarë troje, të cilat i kishin kaluar te personat e tretë. U dënuan me 10-15 apo 20 vjet burgim, por çështja e pronës nuk u zgjidh. Ajo u mbeti përsëri atyre që e morën në mënyrë të paligjshme. Kjo gjë kërkon një studim dhe një analizë që kjo pronë të kthehet përsëri sepse është pronë e shtetit. Nuk kalohet me këto ndryshime inovative që bëni për një orë apo për një ditë, por kërkon një konsultim më të gjerë.

Duke qenë se në pjesën më të madhe të reformës ne kemi përfshirë edhe ekspertë të EURALIUS-it do të doja të ishin të pranishëm edhe ekspertët e tyre më të mirët, me të cilët ne kemi bërë edhe reformën në drejtësi. Do të doja t’i vazhdonit konsultimet, zoti kryetar, në lidhje me këto amendamente të propozuara, sepse ka ende nevojë për ta përmirësuar këtë projektligj. Problemet që ka mosfunksionimi i administratës herë pas herë gjejnë zgjidhjen më të thjeshtë. Ndryshojmë ligjin, kur nuk funksionon një pjesë apo një pjesë tjetër e administratës. Me zotin Lame jemi këtu, kemi bashkëpunuar, por edhe kemi debatuar. Zoti Lame pretendonte që nga ALUIZNI në drejtim të hipotekës nëse ishin bërë 30 mijë shkresa, për 20 mijë nuk ishte përgjigjur hipoteka. Kur i kemi diskutuar nuk kanë rezultuar në këtë mënyrë. Nëse Kryeministri do të mbante një të njerkës dhe një të nënës, sigurisht që ky do të ishte rezultati. Në atë kohë i kemi propozuar Kryeministrit mbi 40-50 faqe informacion për ta zgjidhur problematikën që kishin hipoteka, ALUIZNI dhe nuk e zgjidh ky bashkim mekanik, sepse të gjithë varen nga Kryeministri, por e zgjidh një studim, një konsultim i këtij projektligji për të bërë më të mundshmen, për ta

përmirësuar, por edhe për të pasur një konsensus të gjerë nga opozita, që nuk e ka mohuar mënyrën për ta përmirësuar dhe për ta përsosur këtë ligj.

Besoj se ky ligj do t'u shërbejë të gjithëve, qofshin socialistë, demokratë, me apo pa parti, pasi prona është e shenjtë për të gjithë. Nëse në mënyrë abuzive nga një zyrtar i hiqet apo i shtohet dikujt tjetër, sigurisht që nuk kemi zgjidhur asgjë dhe përgjegjësia është tejet e madhe për ne si ligjvënës. Besoj se nuk do ta kaloni këtë ligj, dekretin me ndryshimet e bëra në mënyrë inovative, kaq të shpejtë, a thua se ju kanë dërguar një telegram dhe duhet ta dërgoni menjëherë. Ai ka nevojë të konsultohet, sidomos me përfaqësuesit dhe ekspertët e EURALIUS-it.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço.

Ka diskutime të tjera?

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Lidhur me dekretin e Presidentit unë që në fillim do të deklaroj votën pro ndryshimeve dhe propozimeve që bën Presidenti. Nuk kam sesi t'i dal kundër dispozitës që parashikon Rregullorja e Kuvendit për ta riparë dhe për të bërë ndryshimet, përmirësimet e mëtejshme, kjo është taksative, aq më tepër që zotërinjtë e opozitës, kur kemi edhe përfaqësuesin e Presidentit, thonë *mot a mot* në relacionin e tyre: “ Duhet të rishikohet në tërësi nga Kuvendi së bashku me projektligjin që është në proces shqyrtimi me qëllim shmangien e kësaj gjendjeje të theksuar pasigurie dhe përshtatjeje të dispozitave të ligjit të miratuar”. Presidenti na thotë shikojeni në tërësi, jeni në vete apo jo? Na hodhët një bombë të madhe që Presidenti na e ka me hile, që pasi të miratohet ky ligj, ai duhet të shfuqizohet, thatë ju zoti Bylykbashi, nuk e di se ku e gjen këtë logjikë?! Nga cila praktikë e ke gjetur, ku e ke dëgjuar? Ti je deputet i vjetër, po ta theksoj dhe njëherë, se Presidenti kërkon rishikimin në tërësi nëse ka mundësi apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

30-20% ku është e ndarë. Nuk ka Rregullore. Zonja relatore ka punuar me kujdes të veçantë. Unë nuk i them në mënyrë inovative, por ka bërë detyrën, përveç vërejtjeve që ka pranuar për çështjet që Presidenti vë në diskutim, ka bërë edhe rregullime të tjera. Ne jemi në linjën e asaj kërkese që kërkon Presidenti i Republikës në këtë rast. Për herë të parë Presidenti kërkon një gjë normale.

Ulsi Manja - Shumë faleminderit, zoti Braho!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Hedhim në votim dekretin e Presidentit të Republikës. Kush është pro pranimit të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11055, datë 15.01.2019 “ Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 111 të vitit 2018 “ Për kadastrën””? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet. Pra, pranohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.11055, datë 15.01.2019.

Sipas nenit 86/2 të Rregullores kalojmë në miratimin e propozimeve për nene të caktuara të këtij projektligji të propozuara nga relatorët.

Ju lutem, e ka kërkuar fjalën përfaqësuesi i Presidentit të Republikës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për procedurë, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, e përsëris ky ligj ka një numër, ka mbyllur procesin legjislativ. Pranimi, votimi i dekretit tani ka rrëzuar ligjin dhe për rrjedhojë kjo që ju bëni më tutje është procedurë në kundërshtim me Kushtetutën. Ligj duhet t’u kthehet nismëtarëve. Nismëtarët mund ta riparaqesin me këto ndryshime apo të tjera, por procesi i mëtejshëm është antikushtetues. Sigurisht që nuk mund të marr pjesë në këtë proces.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Fjalën e ka përfaqësuesi i Presidentit.

Bledar Dervishaj- Në mënyrën që komisioni i nderuar votoi pro dekretit të Presidentit të Republikës, këtu procesi legjislativ për sa i takon vendimmarrjes së dekretit mbi dekretin përfundoi, prandaj unë do të kërkoj leje për t’u larguar. Pjesa tjetër, do të vijë sërish te ne për vlerësim.

Ulsi Manja- Shumë faleminderit, zoti Dervishaj, për prezencën!

Ditë të mbarë!

Sipas nenit 86/2 të Rregullores kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të veçanta të këtij ligji.

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për procedurë, e ka fjalën zonja Caka.

Silva Caka – Përveçse jam totalisht dakord me propozimin e zotit Bylykbashi dhe me arsyetimin që i bëri faktit që nuk duhen të shqyrtohen në këtë seancë këto ndryshime, kemi edhe një fakt tjetër, me *e-mail* nga sekretaria e Komisionit të Ligjeve dje nuk jemi njoftuar për prezencën e këtyre ndryshimeve sot, që do të thotë se nëse ju e keni ndarë mendjen t’i kaloni, na

lini kohë që t'i lexojmë, sepse këto nuk kanë qenë në *e-mail*. Ne nuk jemi njoftuar se sot do të sillej një tabelë me 22 nene, 18 a sa ishin dje, se nuk i numërova...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

22, thotë kolegu im, dhe 30 % e ligjit do të ndryshohet. Ne nuk jemi në dijeni, përveç faktit, siç e thashë edhe një herë, që jam shumë dakord me kërkesën e zotit Bylykbashi, që procesi ligjor u mbyll dhe ligji do të duhet t'u kthehet edhe një herë nismëtarëve. Kështu që, nuk e di, gjykojeni vetë. Unë mendoj se kërkesa është shumë e drejtë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Caka!

Zonja Hysi e ka kërkuar fjalën për procedurë.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E nderuara zonja Caka, meqenëse parashtuat një kërkesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi, për procedurë.

Vasilika Hysi – Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, pas diskutimit në parim për dekretin e Presidentit dhe pranimin të tij, kalohet në diskutimin nen për nen. Secili prej nesh ka të drejtë të shprehet, ndërsa relatorët do t'i paraqesin ndryshimet nen për nen.

Megjithatë, po ta lexoni gjithë punën që kanë bërë të dy relatorët, që me këtë rast do të doja t'i falënderoja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, po kur folët ju, nuk ndërhyra.

Po të shikoni, është respektuar pikë për pikë, gati në 90 % të neneve që propozohet të ndryshohen, kërkesa e Presidentit të Republikës, sipas të cilit, me të drejtë, nuk mund t'i referohesh një ligji, i cili nuk ka hyrë ende në fuqi. Termi që është zëvendësuar në 90 % të dispozitave që rishikohen, është mosreferimi te ligji “Për përfundimin e procesit kalimtar në Republikën e Shqipërisë dhe në aktet ligjore të zbatimit të tij”, të cilin komisioni e ka diskutuar, e ka miratuar, por siç e dini, nuk u votua në seancë plenare për arsye që i dimë shumë mirë ju dhe ne, pra për arsye që nuk varen nga ne. Me të drejtë, në këto propozime kanë ndryshuar edhe referencat, duke thënë që, në përfundim t'i referohemi zbatimit të legjislacionit për çështjet e pronësisë, gjë që është superkorrekte.

Nëse ne, në një nen, nuk gjejmë dot konsensus ose ka nevojë për më shumë komunikim ose kohë për ta studiuar, në raste të tilla kryetari komisionit na e ka dhënë gjithmonë të drejtën për ta lënë dispozitën të hapur, duke e shtyrë kështu votimin në tërësi të projektligjit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Ju lutem, jemi në fazën e shqyrtimit të disa neneve të propozuara nga relatorët në ligjin numër 111 të vitit 2018 “Për kadastrën”. Secili nga kolegë deputetë, që është në këtë tryezë, ka të drejtë të bëjë edhe propozimet përkatëse në lidhje me nenet, që relatorët mendojnë se duhen ndryshuar.

Kjo është praktika normale e punës së këtij komisioni, sepse kemi të bëjmë me një ligj të miratuar, por që pas pranimit të dekretit të Presidentit të Republikës, relatorët, ashtu siç thotë Rregullorja, përpos atyre neneve që ka sugjeruar Presidenti për t’u rishikuar, kanë bërë edhe disa sugjerime të tjera, për të ndërhyrë në nene të caktuara të këtij projektligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Absolutisht! Kështu, që nga relatorët dhe secili nga kolegët, është i lirë të bëjë edhe propozimet konkrete lidhur me nene të caktuara.

Kësisoj, zonja Caka, mund të shtoni diçka për procedurë, por kjo çështje është e mbyllur, sipas nenit 86/2 të Rregullores.

Silva Caka – Nëse nuk e kuptuat qartë atë që thashë, do ta përsëris edhe një herë. Nuk kam asnjë problem lidhur me propozimet I vemi problemi është se ne nuk jemi njohur me këto propozime. Tani, nëse ju e keni ndarë mendjen që këto propozime t’i bëni dhe t’i miratoni ngaqë keni numrat, ju mund të vazhdoni, por minimalisht do t’ju sugjeroja juve në radhë të parë, që të merrni shembull nga paraardhësi juaj dhe të respektoni konsultimin publik. Nuk jua përmenda kot atë të EURALIUS-it qëparë, nuk ishte gallatë, ishte më serioze nga ç’mendoni ju. Duhet bërë konsultimi publik i projektligjeve dhe mbi të gjitha njohja e të gjithë anëtarëve të Komisionit të Ligjeve me materialet.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit!

Zoti Fino, të lutem!

Zonja Caka, kur është miratuar ky ligj, ka qenë në bojkot, kështu që unë, në zbatim të Rregullores nuk kam detyrimin që, kur këta mungojnë, t’i rikthej pas në kohë. Rregullorja nuk ma lejon këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Bushka dhe zoti Fino kanë të drejtë t'i bëjnë edhe tani propozimet për nenet e këtij projektligji, amendamentet për një ligj të caktuar. Unë nuk mund të shpik një rregullore të re, vetëm pse ju munguar për gjashtë muaj në parlament.

Zoti Fino, mund të vazhdojmë.

Bashkim Fino – Për procedurë, kryetar.

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kjo është një kërkesë tekanjoze: “më jepni kohë të lexoj këto pesë ndryshime që kanë sjellë relatorët.”

Pse është e tillë? Është e tillë edhe sikur vërtet të mos kishte kohë fizike, jo që kemi mbi dy orë që diskutojmë këtu. U bë një relacion nga relatorja. U bënë pyetje për relativimin e relatores. U bënë edhe diskutime politike mbi këtë. Arritën të numërojnë edhe nenet, se në sa nene kemi ndërhyrë ne. Tashti, pas dy orë debati, vinë e të na thonë: “na jepni edhe çerek ore apo gjysmë ore kohë, që t'i lexojmë edhe një herë këto ndryshimet që ka paraqitur relatorja”. Kjo më duket absurde.

Megjithatë, nëse këta janë vërtetë të predispozuar të japin ndihmesë, dhe kërkojnë çerek ore, njëzet minuta apo gjysmë ore kohë për t'i lexuar, unë jam plotësisht dakord që ti lexojnë, por jam i bindur se mbas gjysmë ore do të gjejnë një artific tjetër e prapë nuk do ta votojnë nen për nen. Jam shumë i bindur për këtë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Në fakt aq ishte lajmi, zoti Fino, sepse s'e ka hallin te nenet që propozohen, por ishte problemi për të justifikuar largimin nga mbledhja e komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Braho, le të vazhdojmë me nenet!

Spartak Braho – Për procedurë.

Ulsi Manja – Po, zoti Braho!

Spartak Braho – Tani, ajo kërkoi pushim. Le t'ia japim.

Ulsi Manja – Po iku! Çfarë t'i japim?

Spartak Braho – Ne jemi të hapur. Le t'ia japim kohën. Do të vijë prapë. Të shikojmë çfarë ka. Mund të ketë edhe ndonjë hall të madh. Hidhet në votë, votohet propozimi i Silvës.

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Braho, unë nuk mund të hedh për votim një propozim të një kolegu deputet që largohet nga salla e Komisionit të Ligjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu që, ju lutem, a mund të vazhdojmë?

Ju lutem, relatorë! Zonja Bushka, më ndiqni me logjikën e neneve që ju propozoni për t’u rishikuar!

Vazhdojmë me nenin 6. Ju propozoni një ndryshim në nenin 6.

Klotilda Bushka – Ndryshimi është thjesht heqja e referencës në ligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare”, në pikën 1, shkronja “a”.

Ulsi Manja – Ju lutem, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, të ALUIZNI-t e të hipotekës, duhet të shpreheni për ndryshimet që propozojnë relatorët. Jeni dakord me ndryshimet që propozohen te neni 6 i ligjit? Jemi dakord!

Kush është pro ndryshimeve të propozuara nga relatorët për nenin 6?

Pro? Kundër 1. Abstenim s’ka.

Miratohen ndryshimet e nenit 6!

Kalojmë te neni 9.

Nasip Naço – Më fal, zoti kryetar! Ju e njihni Rregulloren,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Shpjegim vote. Patjetër.

Nasip Naço – Votova kundër nenit 6, pasi nuk kemi pasur kohën e nevojshme për ta lexuar, nuk na është paraqitur materiali më përpara, por na ka ardhur në moment, gjatë kohës që diskutonim. Kemi qenë prezentë këtu, kërkuam relacionin dhe an u dha në sy të të gjithëve. Prandaj votova kundër, sepse ky nen ka nevojë për konsultim të vazhdueshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëj edhe një herë kërkesë për ta paraqitur në komision, për t’i kërkuar mendim EURALIUS-it, për të pasur një konsultim më të gjerë në lidhje me këtë projektligj. Kjo ishte arsyeja e votimit tim kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Zoti kryetar, të lutem shumë, pavarësisht si e ka Rregullorja, mos lejo që këtu të bëhet hipokrizi. E di pse? Po të them një gjë shumë serioze...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem! Çfarë votuam ne këtu? Ne votuam propozimet që ka bërë Presidenti i Republikës, për të cilat këta u përgjëruan deri pak minuta më parë. Atë propozim votuam, ndërsa tani thonë: “s’na dhatë kohë ta lexonim, ndaj dhe unë votova kundër”. Tashti hipokrizi mos na bëni.

Ulsi Manja – Jam dakord!

Kalojmë te neni 9.

Relatorët propozojnë ndryshim në nenin 9.

Klotilda Bushka – Njësoj si te paragrafi i mëparshëm i nenit 6. Të hiqet referimi te ligji tjetër.

Ulsi Manja – Kush është pro ndryshimeve që kërkohet t’u bëhen nenit 9?

Pro? Kundër 1? Abstenim s’ka.

Miratohet neni 9.

Kalojmë te neni 10.

Nasip Naço – Kërkoj shpjegim vote.

Ulsi Manja – Të lutem! Relatorët propozojnë ndryshime te neni 10.

Ju lutem, zoti Naço!

Nasip Naço – Të lutem!

Ulsi Manja – Neni 10.

Relatorë, ndizni mikrofonin!

Klotilda Bushka – E njëjta gjë si në dy ndryshimet e mëparshme. Pra, heqja e referencës në projektligjin “Për proceset kalimtare”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro ndryshimeve të nenit 10, sipas variantit që propozojnë relatorët?

Pro? Kundër s’ka? Abstenim s’ka.

Miratohet neni 10, sipas ndryshimeve të propozuara nga relatorët.

Kalojmë te neni 16.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, a mund të shpreheni?

Klotilda Bushka – Hiqet pika 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Bushka, mund të vazhdoni me nenin 16?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Në nenin 16 propozohet të hiqet pika 7, në mënyrë që të hiqet edhe referenca që bëhet në ligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Atëherë, kush është dakord me propozimet që bëjnë relatorët, për të ndryshuar nenin 16 të ligjit?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohen ndryshimet që propozohen për nenin 16.

Kalojmë te neni 22 i ligjit.

Klotilda Bushka – Në lidhje me nenin 22, është bërë një shtesë sa i takon rolit të Ministrisë së Drejtësisë. Shtohet pika 3: “Ministria e Drejtësisë mbikëqyr veprimtarinë e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji”.

Kjo pikë shtohet për efekt të plotësimit të dispozitës së nenit 13, meqenëse është ngritur çështja nga dekreti i Presidentit për të evituar çdo lloj keqkuptimi.

Ulsi Manja – Kush është dakord me propozimin e relatorëve për të ndryshuar nenin 22 të ligjit?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohen ndryshimet që propozohen për nenin 22.

Ka një propozim për ndryshimin e nenit 23 të ligjit.

Klotilda Bushka – Neni 23, njësoj si nenet e mëparshme, hiqet referenca në ligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare”.

Ulsi Manja – Kush është pro ndryshimeve në nenin 23 të ligjit?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet propozimi i relatorëve për ndryshimin e nenit 23 të ligjit.

Klotilda Bushka – Edhe neni 25 ka të njëjtën logjikë: hiqet referenca në projektligjin e kalimit të pronësisë.

Ulsi Manja – Hedhim për votim propozimin për ndryshimin e nenit 25. Kush është pro? Kundër s’ka? Abstenim s’ka.

Miratohet propozimi i relatorëve për ndryshimin e nenit 25.

Kalojmë te neni 28 i projektligjit.

Klotilda Bushka – Në nenin 28, për të evituar çdo lloj keqkuptimi sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, te togfjalëshi në pikën 2, ku themi: “u jepet kodi i hyrjes”, kemi shtuar fjalët: “mund t’u jepet kodi i hyrjes”.

Ulsi Manja – Dakord? Zoti Lame, zoti Pjetri, zonja Voda, dakord?

Atëherë e hedhim në votim.

Ulsi Manja – Kush është pro ndryshimeve në nenin 28, të propozuara nga relatorët?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohen ndryshimet në nenin 28.

Kalojmë te neni 31.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, me mikrofon!

Klotilda Bushka – Amendimin e nenit 31 e tërheqim.

Ulsi Manja – Dakord me tërheqjen e amendimit të nenit 31 nga relatorët?

Dakord!

Kalojmë te amendimi i nenit 34.

Klotilda Bushka – Edhe në nenin 34 ndryshimi ka të bëjë me faktin e heqjes së referimit në legjislacionin “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”.

Ulsi Manja – Hedhim në votim amendimin e nenit 34 sipas relatorëve?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet amendimi i nenit 34, sipas propozimit të bërë nga relatorët.

Kalojmë te neni 37, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Te neni 37 ndryshohet pika “b”, duke iu referuar sugjerimeve në dekretin e Presidentit, në mënyrë që të evitojmë çdo lloj keqkuptimi sa i takon rolit të zyrës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit!

E hedhim në votim amendimin e nenit 37 sipas relatorëve.

Kush është pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet amendimi i nenit 37, sipas formulimit të bërë nga relatorët.

Kalojmë te neni 38 i projektligjit.

Klotilda Bushka – Në nenin 38 hiqen referencat sa i takon ligjit “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”.

Ulsi Manja – Faleminderit!

E hedhim në votim amendimin e nenit 38 sipas relatorëve?

Kush është pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohen ndryshimet në nenin 38, sipas propozimeve të bëra nga relatorët.

Kalojmë te neni 40.

Klotilda Bushka – Neni 40 ka vetëm shtesë titulli, sepse duhej plotësuar për efekt të teknikës legjislative.

Ulsi Manja – Kush është dakord me amendimin e nenit 40 sipas relatorëve?

Kush është pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohen ndryshimet në nenin 40 të ligjit.

Kalojmë te neni 41.

Klotilda Bushka – Edhe neni 41 ka shtesë titulli, për efekt të teknikës legjislative.

Ulsi Manja – Dakord!

Kush është pro ndryshimeve të propozuara për nenin 41?

Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohen ndryshimet në nenin 41 sipas propozimeve të bëra nga relatorët.

Kalojmë te neni 53.

Klotilda Bushka – Te neni 53 janë bërë disa ndryshime. Hiqet referenca në ligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare”. Në fillim fare ndryshohet titulli, sepse procesi kalimtar referohet gjithashtu edhe në titull. Po ashtu saktësohet dispozita për të marrë kuptim fakti i regjistrimit të pasurive që janë të legalizuara, që janë në truall në pronësi të të tretëve, por që janë ndërtime pa leje e që legalizohen, që të garantohet siguria e së drejtës së subjekteve, të cilat kanë të drejtë të përfitojnë nga regjistrimi i këtyre pasurive.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush është dakord me amendimin e nenit 53, që ndryshon edhe titullin, edhe një pjesë të përmbajtjes, sipas relatorëve?

Pro? Kundër s’ka. Abstenim s’ka.

Miratohet amendimi i nenit 53 sipas formulimit të bërë nga relatorët.

Kalojmë te neni 66.

Klotilda Bushka – Në nenin 66 bëhet një ndryshim i nenit, që të përkohet me rregullat procedurale civile, sepse bëhet fjalë për proceset gjyqësore, ku nga “kufizime të arsyeshme” bëhet “pjesëmarrje e detyrueshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në proceset gjyqësore”.

Pika 2 ndryshohet në kuadër të këtij titulli, ku në fakt gjykata, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve civile, për nevojat e gjyqimit mund të ketë të domosdoshëm dokumentacionin kadastral. Sigurisht, mund të urdhërojë drejtorinë vendore të ASHK-së, për t'i hartuar ato sipas parashikimeve të ligjit. Pra, saktësohet roli i ASHK-së në proceset gjyqësore.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Kush është dakord me amendimin e nenit 66, sipas formulimeve të bëra nga relatorët?

Pro? Kundër s'ka? Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 67.

Klotilda Bushka – Neni 67 ka të bëjë me rregullimet që i duhen bërë ligjit tani, duke u nisur nga fakti që nuk hyn dot më ën fuqi më 1 shkurt, ndaj duhet riparë procedura e hyrjes në fuqi të ligjit. Pra, ligji do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, por ndërkohë do të kemi një periudhë kalimtare nga shkrirja e tre institucioneve deri në krijimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, arsye për të cilën duhej saktësuar neni 67, sepse ka ndryshuar afati i hyrjes së ligjit në fuqi. Kësisoj, neni 67 ka pikërisht këtë tekst, kur krijohet agjencia, dhe jo më vonë se një muaj.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Kush është dakord me amendimin e nenit 67 të ligjit, sipas variantit që propozojnë relatorët?

Pro? Kundër s'ka? Abstenim s'ka.

Miratohen ndryshimet te neni 67!

Kalojmë te neni 68: “Bashkëpunimi ndërinstitucional”.

Klotilda Bushka – Është heqja e referencave tek ligji “Për proceset kalimtare”.

Ulsi Manja – Kush është pro ndryshimit të nenit 68 të ligjit, sipas variantit të relatorëve? Kundër s'ka? Abstenim s'ka.

Miratohet neni 68!

Kalojmë te neni 69.

Zonja Bushka.

Klotilda Bushka – E njëjta çështje që u parashikua në nenin 67, sa i takon periudhës kalimtare. Këtu, te neni 69, detajohet me hapa.

Ulsi Manja – Kush është dakord me amendimin e nenit 69, sipas variantit të propozuar nga relatorët? Kundër s'ka? Abstenim s'ka.

Miratohen ndryshimet në nenin 69!

Kalojmë te neni i fundit, që është neni 73.

Klotilda Bushka – Në nenin 73 propozohet që hyrja në fuqi e ligjit të bëhet 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, sepse më përpara ishte më 1 shkurt, afat i cili ka kaluar.

Ulsi Manja – Kush është pro amendimit të nenit 73, sipas variantit të propozuar nga relatorët? Pro? Kundër s'ka? Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me propozimet për ndryshimin e neneve që sapo kaluam, të ligjit numër 111, të vitit 2018 “Për kadastrën”?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet edhe në tërësi ndryshimi i neneve që sapo votuam në ligjin numër 111 të vitit 2018 “Për kadastrën”.

Në zbatim të nenit 86/2 të Rregullores, relatorët e këtij ligji, të bëjnë gati raportin për seancën, së bashku edhe me propozimet që sapo votuam për nenet e caktuara të këtij ligji.

Këtu e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Shumë faleminderit për kohën dhe debatin konstruktiv!

Mbledhja e radhës do të jetë nesër. Rendi i ditës dhe ora do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

